



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"  
SENATI

Nr. 3071 prot.

Shkodër, më 12. 10. 2022

V E N D I M

Nr. 201, datë 12. 10. 2022

**"Për kuotat dhe kriteret e programeve të reja për vitin akademik 2022-2023"**

Bazuar në Ligjin nr. 80/2015, dt 22.07.2015 "*Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë*", Neni 69, pika 3; Statutin e USH-së Neni 17, pika 6, germa n, Neni 53, pika 1, me propozim të Njësive kryesore, Senati Akademik, me vendim qarkullues të datës 12.10.2022

**Vendosi:**

1. Miratimin e kuotave të pranimit, siç janë paraqitur në aplikim, për kandidatët konkurrues që aplikojnë për të ndjekur studimet në USH për pragramet e reja në ciklin e parë dh të dytë të studimeve për vitin 2022 – 2023:
  - a. Master i shkencave në Studime të historisë dhe kulturës shqiptare- 30 kuota.
  - b. Master profesional Mësues i Artit Pamor -30 kuota nga këto 28 brenda vendit, 1 troje dhe 1 me aftësi ndryshe.
  - c. Master profesional Mësues muzike -30 kuota, nga këto 28 brenda vendit, 1 troje dhe 1 me aftësi ndryshe.
  - d. Master profesional Zhvillim Programesh të Avancuara -20 kuota
  - e. Bachelor në Biologji -Kimi në Anglisht 10 kuota (nga kuotat e miratuara për programin në gjuhën shqipe)
  - f. Bachelor në Informatikë në gjuhë angleze – 10 kuota (nga kuotat e miratuara për programin në gjuhën shqipe)
  
2. Miratimin e kriterëve të pranimit (sipas materialit bashkëlidhur) për kandidatët konkurrues që aplikojnë për të ndjekur studimet në USH për pragramet e reja në ciklin e parë dh të dytë të studimeve për vitin 2022 – 2023
  - a. Master i shkencave në Studimeve të historisë dhe kulturës shqiptare
  - b. Master profesional Mësuesi në Art Pamor

- c. Master profesional Mësues Muzike
  - d. Master Zhvillim Programesh të Avancuara
  - e. Bachelor në Biologji -Kimi në Anglisht
  - f. Bachelor në Informatikë në gjuhë angleze
3. Ky vendim, i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETORE**  
**Prof. Dr. Suzana GJILIMI**



The stamp is circular and contains the text "REPUBLIKA E SHqipëRI" at the top, "UNIVERSITETI I LUIGJ BULE" on the left, "FACULTATI I EDUKIMIT" on the right, and "SHKODER" at the bottom. In the center is a coat of arms featuring a sun and a star. A blue ink signature is written over the stamp.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Universiteti i Shkodrës "LuigjGurakuqi"

Shkodër, më 12.10.2022

**Lënda: Kriteret e pranimit për programet e reja 2022-2023**

**1. Master shkencor në "Studime të historisë dhe kulturës shqiptare"**

Kriteret e pranimit:

Kriteret e përgjithshme

- a. Të ketë një mesatare të përgjithshme të ponderuar sipas pikëve kredite të cdo lënde jo më të ulët se 7 ( shtatë).
- b. Të paraqesë një kërkesë të motivuar për programin e studimit të zgjedhur.
- c. Kandidatët që vijnë nga njësitë bazë të ndryshme nga njësia që mbulon programin e studimit të kërkuar , të paraqesin dy rekomandime nga titullarët e njësive ku ata kanë kryer studimet e ciklit të parë Bachelor.

Kriteret e vecanta

- a. Një diplomë bahelro nga një universitet i shkencave humanitare, ose një diplomë të njëvlefshme nga një institucion ekuivalent i saj.
- b. Kandidati duhet të shfaqë interes të dukshëm në fushat e Historisë së Shqipërisë , Gjuhësisë Shqiptare dhe Letërsisë Shqiptare, Antropologjisë Kulturore, përfshirë njohuritë më të rëndësishme të çështjeve të kërkimit dhe metodave.
- c. Të shfaqin aftësi të spikatura në fushën kërkimore në nivelin mbi mesatar. Studentët që aplikojnë duhet të kenë një notë mesatare mbi 7 ose për studentët e huaj ekuivalenten e kësaj note sipas sistemit të shkollës shqiptare.

- d. Motivim të fuqishëm për të kryer kërkim shkencor dhe ambicje për të ndjekur një program për tu bërë studiues dhe kërkues shkencor. Një gjë e tillë do të duhet të shfaqet në mënyrë të qartë në letrën e motivimit dhe intervistën e pranimit.

## 2. Master profesional "Mësues i artit pamor":

Kriteret e pranimit:

Studentët që do regjistrohen në programin e studimit Master profesional "Mësues i Artit Pamor" duhet të kenë diplomë Bachelor, ose të sistemit të kaluar 4-vjeçar, të fituar në një nga programet e studimit në fushën e Artit Pamor.

Konkurrimi për regjistrim në këtë program zhvillohet me dosje.

## 3. Master profesional "Mësues muzike"

Kriteret e pranimit:

Studentët që do regjistrohen në programin e studimit Master profesional "Mësues muzike" duhet të kenë diplomë Bachelor, ose të sistemit të kaluar 4-vjeçar, të fituar në një nga programet e studimit në fushën e muzikës.

Konkurrimi për regjistrim në këtë program zhvillohet me dosje.

## 4. Master profesional Zhvillim programesh të avancuara

Kriteret e pranimit .

Në këtë cikël pranoen studentë me :

- Diplomë Bachelor Informatikë
- Diplomë Bachelor Shkenca Kompjuterike
- Diplomë Bachelor Matematikë
- Diplomë Bachelor në Informatikë-Ekonomikë

Ato individë që kanë përfunduar studimet jashtë vendit duhet të njohin diplomën në MASR.

## 5. Bachelor në Informatikë në gjuhën angleze

Kriteret e pranimit:

Në këtë program studimi mund të hyjë çdo student që ka përfunduar me sukses maturën shtetërore ( provimet e të cilit kryen pas 12 -13 viteve të shkollimit të përgjithshëm) . Kanë të

drejtë të pranohen edhe persona që kanë kryer kualifikime të tjera të barazvlefshme jashtë vendit. Gjithashtu kandidatët të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe të kenë mbrojtur gjuhën angleze të paktën deri në nivelin B1 . Kandidatët duhet të kenë vlerësimet e gjuhës angleze në ciklin parauniversitar të paktën me notën 7.

#### 6. Bachelor në Biologji Kimi në gjuhën angleze

Kriteret e pranimit:

Në këtë program studimi mund të hyjë çdo student që ka përfunduar me sukses maturën shtetërore ( provimet e të cilit kryen pas 12 -13 viteve të shkollimit të përgjithshëm). Kanë të drejtë të pranohen edhe persona që kanë kryer kualifikime të tjera të barazvlefshme jashtë vendit. Gjithashtu kandidatët të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze dhe të kenë mbrojtur gjuhën angleze të paktën deri në nivelin B1 . Kandidatët duhet të kenë vlerësimet e gjuhës angleze në ciklin parauniversitar të paktën me notën 7.